



Informata për prindë mbi kalimin e nxënësve në klasët e larta

Të dashur prindë

Pas vijimit të shkollës fillore për fëmijun e juaj vjen koha e kalimit në klasët e larta. Këtu vjen në shprehje pyetja, se në cilin tip të klasëve të larta, në shkollën reale apo në shkollën sekondare do të cakohet fëmiju juaj. Ku do të ketë nxitje e ndihmë më të madhe për fëmijun e juaj.

Kjo broshurë do t' u sjell informata themelore për klasët e larta.

DEPARTAMENTI I EDUKIMIT
I KANTONIT ST. GALLEN
Dikasteri për shkollën popullore
Davidstrasse 31
9001 St.Gallen

Qershor 2003

Klasët e larta

Klasët e larta të shkollës popullore bashkangjiten pas klasës së gjashtë të shkollës fillore dhe zgjasin tri vjet. Klasët e larta ndahen në shkollën reale, shkollën sekondare dhe në klasë të vogëla. Klasët e larta i përgatisin nxënëset e nxënësit për arsimim profesional apo për vijimin e shkollimit më tutje si dhe në përballimin e jetës së përditëshme. Ndarja e klasëve të larta u mundëson nxënësve dhe nxënësive që të marrin një arsimim mesatar në krahasim me talentin dhe aftësitë e tyre për mësim. Ndryshimet e tri tipeve qëndrojnë në pretendimet e aftësive intelektuale, në mënyrën dhe formën e ndihmës për arsimim elementar, kompetencën për mësim dhe suksesin.

Shkolla reale

Shkolla reale jep një arsimim themelor e të gjithënjashëm, ndihmon gadishmërinë për mësim dhe forcon besimin e të rinjëve për aftësitë e tyre për punë. Shkolla reale jep një arsimim të përgjithshëm në lëminë gjuhësore, matematikore, të shkencave natyrore dhe muzikore. Ajo i përgatitë të rinjtë për jetën profesionale, për zanate, për industri dhe për profesionet shërbyese.

Shkolla sekondare

Shkolla sekondare u dedikohet nxënësve dhe nxënësëve, të cilët kanë sukses të mirë, janë të qëndrueshëm në mësim, tregojnë një interes e gadishmëri më të lartë për mësim. Shkolla sekondare ofron një arsimim të përgjithshëm me kërkesa më të larta në lëminë gjuhësore, matematikore, të shkencave natyrore e muzikore. Ajo krijon një bazë të mirë si për arsimimin profesional me dhe pa maturë profesionale e poashtu edhe për shkollim të mëtutjeshëm.

Mënyra e kalimit në klasët e larta

Për kalimin e një fëmiu pas klasës së gjashtë në shkollën reale apo sekondare vendos Këshilli i shkollës për klasë të larta. Bazë vendimtare për këtë janë:

- a) Propozimi i mësuesit të klasës së gjashtë
- b) Notat e klasës së gjashtë (Dëftesa e semestrit të parë dhe gjendja e suksesit në kohën e paraqitjes)

Sipas rregullit, në semestrin e parë të klasës së gjashtë bëhet një bisedë vlerësuese me mësuesin e klasës. Në majin mars apo prill organizohet një bisedë për përcaktim. Mësuesi u tregon prindërve apo kujdestarit për edukim kërkesën për përcaktim.

Në qoftë se prindërit nuk janë të pëlqimit me kërkesën për përcaktim, kanë mundësinë të bëjnë një ankesë për rishqyrtim nga organet shkollore. Ky rishqyrtim krijon bazën për një vendim të ri të Këshillit të shkollës së klasëve të larta.

Pas vendimit për përcaktim, pas ankesës në Këshillin shkollor të rrethit, fëmiu shkon në klasën e caktuar të klasëve të larta. Komunat shkollore mund të bëjnë kriteriume shtesë dhe për kalimin në klasë të larta mund të caktojnë një kohë provuese. Koha provuese zgjatë dhjetë javë.

Ndihma për përcaktim

Kriteret për përcaktim në shkollën reale apo në shkollën sekondare janë në mes tjerash përmbledhje e suksesit, qëndrimin ndaj punës, motivimi, dëshira për mësim. Pikë të rëndësishme paraqesin notat. Rezultati dhe mënyra e vlerësimit do të bëhet në një bisedë të përbashkët në mes mësuesit dhe prindërve. I riu mund të marrë pjesë në bisedë.

Ndërrimi i tipit të shkollës në klasët e larta

Nxënësit e shkollës reale në qoftë se arrijnë sukses të jashtëzakonshëm pas një viti mund të vazhdojnë klasën e parë të shkollës sekondare. Me një sukses të jashtëzakonshëm është i mundur kalimi pas klasës së dytë reale në klasën e dytë të shkollës sekondare.

Në qoftë se nxënësi apo nxënësja e shkollës sekondare nuk mund t' i përballojë me sukses të mjaftueshëm kërkesat e klasës, ai kalon në klasën përkatëse të shkollës reale. Kalimi bëhet sipas rregullores për kalim në klasët e larta dhe sipas rregullores për promovim.

Kalimi në klasët e vogëla

Në klasët e vogëla nxënëset dhe nxënësit me vështirësi për shkollë do të ndihmohen në mënyrë të veçantë sipas nevojave të tyre.

Për kalim në klasë të vogël bëhet një veprim special. Kërkesën e bëjnë prindërit apo mësimdhënësi, por duhet të merret edhe një vlerëim i Shërbimit shkollor psikologjik. Kompetencën për vendim e ka Këshilli i shkollës, ndërsa instanca për ankesë është Këshilli për edukim. Kalimi në klasë të vogël mund të bëhet edhe gjatë vitit shkollor. Këshilli i shkollës çdo vit rikontrollon se a është i mundshëm këthimi në klasë të rregullt.